

Tipologjia e Personazheve në Romanet e Ismail Kadaresë



Letërsi

Fjalë kyçe: proza, poetika moderne dhe postmoderne, tipizimi i personazheve, etj.

Arlind Farizi

Fakulteti Filologjik, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.
Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Abstract

Edhe pse në teorinë e re të prozës, një koncept që ka të bëjë me mënyrën origjinale të shkrimit të saj, në varësi të poetikës moderne dhe postmoderne, janë dhënë mjaft vërejte rreth tipizimit të personazheve, si mënyrë e karakterizimit të tyre, sidomos nga poetika e realizmit, përpos të tjerash, dimë se parimet e ndërtimit të personazheve, në të gjitha anët përfaqësuese të tyre, mbështeten edhe në tipizimin e tyre, që dihet se nënkupton dhënien e tipareve përfaqësuese të një grupi apo shtrese njerëzish, një personazhi të vetëm. Në këtë mënyrë, të figurimit tipik dhe karakteristik, personazhi i një vepre nuk përfaqëson vetëm veten, por edhe të tjerët individ, që kanë ato tipare të përtheksuar në një karakter. Personazhe të tilla, të plasura në të gjitha përmasat, fizike dhe morale, sociale dhe tipike, gjejmë në të katër romanet e Kadaresë. Ato nuk janë ndërtuar duke marrë për bazë veçoritë dhe tiparet e një personi të caktuar, por pas studimit të shumë personave që i takojnë të njëjtit grup, klasë apo shtresë, kryesisht janë zgjedhur vetitë që janë më tipike dhe që e përfaqësojnë më denjësisht realitetin, me të gjithë kompleksitetin që bart.

Kadare, edhe pse është nga ata shkrimtar që nuk ka kaluar kohë të gjatë në mesin e popullit dhe përsëri ai ka arritur të njohë njerëz me attribute të ndryshme, të cilët më pas i ka sintetizuar, përpunuar dhe i ka shfrytëzuar me mjeshtëri për karakterizimin e personazheve të veta. Bujqit, argatët, peshkatarët dhe punëtorët e varfër, kooperativistët, aristokratët, udhëheqësit komunistë, klerikët e shumë të tjerë janë tipat më të njohur, që në përgjithësi e përbëjnë botën e romaneve të Kadaresë, por brenda secilit prej grupeve të paraqitura në romanet e tij, pavarësisht ndryshimeve të pranishme, shpesh herë edhe thelbësore, gjejmë nëngrupe të tjera që bartin tipare më specifike, të cilat gjejmë shprehje në hapësirat e romaneve të tij. Në optikën e realizmit të personazheve, në tiparet fizike dhe morale, në procesin e tipizimit dhe karakterizimit të tyre, sërish Kadare, ecën më tepër një rrugëtim të gërshetimit të skicimit të tyre, duke pranëvënë portretizimin klasik, me jo pak elemente të natyrës moderne. Me interes do të ishte krahasimi i tipologjisë së vizatimit të personazheve nga Kadare dhe autorë të tjerë, ku për të kapur diferencën, do të ishte me interes vështrimi i mënyrës së si konceptohen, realizohen personazhet nga Kadare, si dhe për të parë hapësirat e ndryshimit në skicimin e personazheve nga ana e Kadaresë.

Tipizimi i personazheve, të shumtë dhe të larmishme, i realizuar mjeshtërisht nga Kadare, në fakt mundëson njohjen e strukturës së shoqërisë shqiptare, por edhe më vonë, problemet dhe kontradiktat e mëdha, që padyshim kanë sjellë deri në kolapsin e plotë të saj, përfshirjen e punëtorëve dhe fshatarëve në luftën kundër fashizmit dhe peripecitë e shumta, që e kanë përcjellë shoqërinë shqiptare në vitet pas çlirimit, në përpjekjen për të sjellë atmosferën e ndryshimit të madh në këtë hapësirë. Vihet re, se personazhet e Kadaresë, ndonëse në thelbin e tyre janë realist, kohën dhe tiparet e saj, në një masë të madhe ndryshohen, madje në disa raste deri në një përmbysje të plotë të karaktereve dhe tipave të ndryshëm që ndeshim në jetën e përditshme.

Kadare, në pjesën më të madhe të romaneve të tij, posedon një laramani të madhe personazhesh, të marrë nga jeta konkrete, si dhe të transformuar, falë të cilëve lexuesit e romaneve të autorit, kanë kënaqësinë të shohin ligjëratat dhe rrëfime nga më të ndryshmet. Personazhet e Kadaresë janë aq të shumtë sa që është e pamundur të mundohesh t'i ndash në disa grupe ose edhe në dy grupe të mëdha, siç është bërë zakon kur e kemi fjalën për personazhe pozitiv dhe negativ, gjithënjë si një ndarje për të kapur dhe trajtuar mënyrën e figurimit të personazhit.

Prezenca e shumë të personazheve është karakteristike për veprat e Kadaresë, të cilët përpos të tjerash, krijojnë mundësinë e realizimit të polifonisë, pra të pranisë së kaq shumë zërave. Megjithatë të mos keqkuptohemi me këtë fakt, prania në një vepër të caktuar, me shumicë e personazheve s'është ajo që e bën më të fuqishme një vepër. Sepse mund t'ia përmbledhësh lexuesit një ushtri të tërë personazhesh dhe në mesin e gjithë atyre lexuesi të mos mund ta

gjejë veten askund, pra të mos ketë lidhje, as formale. Tani shtrohet pyetja: A thua vallë është patjetër e domosdoshme që ta gjejë ai veten tek ndonjëri nga personazhet? Padyshim që jo, sepse letërsia nuk fotografon, por realizon një përthyerje të plotë të gjithë realitetit, padyshim edhe të personazheve. Mirëpo, të ndërtosh një personazh, me të gjithë elementët e vetë përbërës, të realizimit fizik dhe moral, dhe pastaj të arrish që lexuesi ta gjejë veten tek ndonjëri prej tyre d.m.th që ai është miqësuar më shumë me veprën dhe gjatë leximit do jetë kureshtar për fatin e ndonjërit prej tyre, si me thënë ndjehet shumë më afër se sa me personazhet e tjerë. Thënë pak më thjesht, në këtë mënyrë autori arrin që të zgjojë interesin e lexuesit, në të gjitha format e skicimit të vetë. Përkundër kësaj, në një vepër letrare, mund të kesh një grusht personazhesh dhe të gjithë t'i duash njëlloj ashtu si nëna që s'i ndanë dot fëmijët e saj, por gjithnjë duke patur një personazh që e ke më shumë për zemër. Megjithatë, në lidhje me personazhet, e secilit roman, pra edhe me romanet e Kadaresë, edhe pse të pakta janë gjasat që autori t'i ketë spikatur aq mirë sa që lexuesi do të mishërohej me to që në fillim të veprës, çka zjgon interesin e lexuesit në të gjitha kuptimet.

Megjithëkëtë të përlindësh gjithë këto personazh, në kuptimin e tipizimit të plotë të tyre, t'u japësh jetë atyre, t'u japësh shpirt, ta quash veten krijues i tyre duhet së pari të kesh talent dhe guxim, që do të mundet të realizonte shembëllimin e plotë të këtyre figurave. Nuk është kaq e lehtë që të shetisësh në vende të ndryshme të botës, të kontaktosh me kultura dhe popuj të ndryshëm, të cilat portretizohen si tipare në personazhet me kryesore. Mund të mos jesh në gjendje as edhe t'i përshëdesësh ata, gjithnjë dhe vetëm në varësi të tipave dhe karaktereve, që përfaqësojnë në hapësirat e teksteve të romaneve. Por një autor siç është Kadare, padyshim autori më i njohur i letërsisë shqipe në botë, zakonisht i ulë ata pranë vetes, miqësohet dhe pastaj rrëfimi është paksa më se spontan, si të thuash ecën me ta në hapësirat e tekstit, duke lënë kështu me gjurmë unike.

Në qoftë se e përqendrojmë sadopak vëmendjen gjatë leximit të veprave, pikërisht në këtë shenjë, vërejmë rëndësinë që u kushton autori profesioneve që ushtrojnë personazhet e tij, të cilat edhe janë të përzgjedhura, por po ashtu janë të zhvilluara plotësisht në të gjithë hapësirën e tekstit. Madje, ato ai shpesh herë në tekstet e romanedve të tij, ndërkaq i përshtat me botën e tyre shpirtërore, aq të larmishme. Megjithatë, jo çdoherë bota shpirtërore e përcakton profesionin, por ama ndodh, jo rrallë, që edhe profesioni i zgjedhur në jetë, ndërkaq të jetë përcaktues i fateve njerëzore. Tani që pak a shumë jemi të njohur me varësinë fat-profesion, si një binom përcaktues i tipareve të personazheve, mund të vëmë gishtin në kokë dhe të mendohemi një çik se sa e rëndë do ketë qenë të përcaktosh fatin e njeriut, po kaq të përcaktosh profesionin, si dhe t'i shtrosh të kaluarën ekzistenciale të tij dhe po kaq të jesh parashikues i të ardhmes së tij.

Të jesh krijues i gjithë këtyre elementeve, fizike, morale dhe profesionale, që kanë të bëjnë me qenien më të ndërlikuar të quajtur njeri, s'do ketë qenë aspak e lehtë, pavarësisht mjeshtërisë së Kadaresë. Mirëpo, para vetes kemi një shkrimtar të madh, një mjeshtër gjenial, të strikurës dhe kompozimit, po kaq tqë shprehësisë dhe figurimit të personazheve, kur flasim për magjinë e quajtur shkrim. Andaj duke shfrytëzuar aftësinë dhe talentin e tij, për të realizuar personazhet në gjithnashmëri, ai ka vënë në përdorim profesione të shumta. Ka vënë në përdorim madje edhe ato profesione që mbase ne me pa të drejtë mund të mos i kemi dëgjuar asnjëherë, që gjithsesi janë unike ose shumë të rralla si: aktorë, administratorë, doktorë, falltarë, fallxhësia, furrëtarë, doganierë, dasmëprishës, gështenjapjekës, bujq, poetë, këngëtarë etj, të cilët krijojnë pamjet konkrete të protagonistëve.

Në veprën e tij, tqë gjerë dhe të larmishme, po ashtu edhe të pasur në shkrimin e romanit, hasen personazhe, që nuk kanë emër dhe mbiemër, por që zakonisht thërriten me ndonjë nofkë, zakonisht në përshtatje me profesionin që ushtron apo cilësi fizike që e karakterizon, etj, pra duke bërë kështu një emërtim profesional. Megjithatë, fakti që ata nuk kanë emër dhe mbiemër nuk i bën më pak të rëndësishëm, përkundrazi i bën personazhe edhe më përfaqësuese. Në rastin konkret, pra, tek romani "Kush e sollli Doruntinën", një tekst që realizon edhe një ikje nga realiteti bashkëkohor, duke zbritur në mesjetën e hershme, Doruntina nuk ia dinim emrin, ndihmësit të Stresit, ai gjatë gjithë veprës paraqitet vetëm si "ndihmësi" pastaj ishte shitësi i ikonave, ishin vajtojcat, etj, të cilët megjitha rolin që kryjnë në hapësirat e tekstit romanor, këtu vijnë si bartës të profesioneve.

Përveç këtij grupi personazhesh, të një tipologjie jo pak të përfshirë në mënyrën se si skicohen personazhet e autorit, në veprën e tij hasim edhe personazhe që nuk janë të pranishëm në kohën e veprimit, pra personazhe që bëhen

të pranishëm me papraninë tyre, por që edhe ata luajnë rolin jo të vogël, që u caktuar autori në hapësirën tekstologjike. Në rastin konkret i tillë është Konstandini i cili nuk jeton, është i vdekur, por që në këtë roman luan rol qendror, madje ai është i pranishëm që në fillim gjer në fund të veprës, pra është një epiqendër e realitetit imagjinar dhe letrar, domethënë vepra hapet dhe mbyllet me të, si një figurë hije, por tejet e pranishme në rolin që bart mbi supe. Të njëjtit grup i takojnë edhe vëllezërit e Konstandinit, rënë në fushën e betejës shumë kohë më parë se sa ky i fundit, të cilët nuk veprojnë në vepër, por që herë pas here përmenden, pra janë të pranishëm, mbase më tepër si hije që ndjekin veprimet e personazheve të tjerë të veprës.

Një lloj tjetër personazhesh, që është edhe më i rralli në hapësirat e këtij teksti, janë personazhet kolektive, siç janë vajtojcet dhe shokët e Konstandinit, dy grupime personazhesh me peshë specifike në këtë tekst. Tani, duke u mbështetur kryesisht në pamjen e tyre, psikologjinë e larme, vendin dhe peshën që zënë në vepër, rolin që luajnë aty të shpallim disa prej tyre pikërisht ata me të cilët mendojmë që ka ecur vepra.

Nëse ndalemi te personazhi i Doruntinës, të romani Kush e solli Doruntinën, mund të themi se është personazhi më i bukur, më tërheqës dhe më tragjik. Megjithëse, pamjen e saj të jashtme, pra portretizimin fizik, autori e thekson fare pak, ne dimë që ajo ishte një vajzë e bukur, me një trup të hollë dhe një fytyrë të bardhë engjëjllore, kurse flokët e saj ishin të verdhë andaj disa herë në vepër e hasim, të emërtuar nga autori, si ‘leshverdhja’. Ajo që të bën më shumë përshtypje te personazhi i Doruntinës, figura qëndrore e veprës është durimi që disponon ajo si dhe qetësia përballë shumë hidhërimesh. Të lë përshtypjen, në pamje të parë, sikur u është dorëzuar ligjeve të domosdoshë njerëzore dhe nuk proteston për asgjë, madje nuk reagon për asgjë, sepse e konsideron të kotë. Gjithashtu, konsiderohet si personazhi më tragjik i veprës, që buron nga fati i saj, tragjik si marrëdhënie me familjen e gjakut. Gjatë gjithë kohës artistike, pra të pranisë së saj, shohim ta kenë ndjekur fatkeqësi, të shumta dhe të ndryshme, duke filluar që nga martesja e largët, që ka kapërcyer nëntë male, te malli për familjen dhe vëllezërit e saj, deri te kthimi tragjik për tu përqaftuar me vdekjen, me matanë jetën ku janë njerëzit më të dashur të saj.

Edhe pse zë vendin qendror në vepër, Doruntinën e shohim të flasë pak, sepse gjatë gjithë veprës flet autori në vend të saj, pra jemi në një skicim të tërthortë të personazhit. Fjalët e saj të vetme, që ka pohuar në hapësirën e tekstit, do kenë qenë ‘Konstandini’, ‘po’, ‘jo’ ose vetëm një pohim me mbylljen e syve, pra është një figurë e saklitur përmes fjalës së shkrimtarit. Sidoqoftë, ajo hyn në grupin e personazheve që flasin pak, por thonë shumë, në kuptimin që prania e tyre, në skenë dhe veprim, është nga ato momente që zbulon praninë e saj në të gjitha kuptimet. Vendi i saj në familje gjithashtu ishte i rëndësishëm, madje është jetike, sepse bart atribucion e përfaqësimit të vetes, por edhe të familjes, të vëllezërve të rënë në fushën e betejës, që vetëm sa thellon notat tragjike të kësaj atmosfere. Ishte vajzë e vetme e familjes Vranaj, motër e nëntë vëllezërve, shoqe e një të huaji nga Bohemia, ku bie në sy fakti i pranisë së numrit nëntë, një numër me peshë në poetikën gojore, por edhe të kultivuar të artit të fjalës. Doruntina zë pak vend në faqet e romanit, sepse ajo ikën shumë herët, sapo zbulohet sjellësi i saj, por është e gjithë pranishme në fatin dhe ekzistencën e saj. Megjithatë, së paku siç e paraqet hapësira e këtij teksti, figura e saj është më delikatja, më e bukura dhe më tragjika njëkohësisht.

Pasi u ndalem të romani Kush e solli Doruntinën, edhe personazhi i Konstantinit na shfaqet si personazh që nuk është i pranishëm gjatë gjithë veprimit të ngjarjes në vepër. Edhe pse i vdekur, pra, që i përket botë së të ikurve, të vdekurve, të cilët janë shuar me kohë, ai luan rol të madh në gjithë zhvillimin e ngjarjes, me një fjalë; ai edhe pse jo fizikisht, është me praninë si frymë e mbajtjes së fjalës së dhënë, në vepër që nga fillimi deri në mbyllje. Ai është vëllai më i vogël prej gjithsej nëntë djemve që kishte familja Vranaj, të cilët janë shuar në betejat e shumta me pushtuesit e atdheut. Në veçanti na kujtohet për nguljen këmbë që motrën ta martojë larg vendit, pra është shkaku, me kushtin që sa hertë të kishte nevojë do ta sillte. “Ai i pranonte martesat në vendet e largëta, fliste kundër kishës bizantine dhe nuk kishte ndonjë nderim kushedi çfarë për fenë”.

Ndërkaq, përveç këtyre tipareve, që kanë të bëjnë me tiparet më përfaqësues të këtij personazhi, atë më së shumti, e karakterizonte qëndrimi dhe dashuria ndaj besës, fjalës së dhënë, gjë që e mësojmë nga vetë shokët e Konstandinit në bisedë me Stresin. Sipas tij, besa shqiptare, që është diku brenda shpirtit njerëzor ishte shumë më me vlerë, ishte shumë më e fortë se ligjet që ekzistonin në institucionet shtetërore dhe në të gjitha llojet e institucioneve

të tjera. Sa i përket pamjes së tij të jashtme autori nuk ka dhënë ndonjë përshkrim, pra e ka heshtur. Mbase dhe qëllimisht! Në fakt heshtja ndaj këtij portretizimi, është edhe gjetja më e fuqishme artistike, sepse ka dashur që pamja e të vdekurit, e botës së përmatanshme të mos e errësojë skenën... Mbase e ka llogaritur të parëndësishme këtë gjë, por është më tepër një kumtim etik dhe estetik tejet i gjetur. “Konstandini është figura e të vetmit disident në galerinë e personazheve kadareane. Ai nuk është aspak kundërshtar politik i shpallur, por i përket botës së fantazmave dhe ashtu si shajnitë e të atit të Hamletit, ai rikthehet për të trazuar shpirtin e të gjallëve”.

Edhe Stresi na del si njëpersonazh aktiv dhe njëherit edhe enigmatik në veper, që rrëfen dhe analizon ngjarjet, si të thuash ai është zëri i autorit që na vjen me anë të zërit të personazhit. Luan rolin e kapitenit, udhëheqësit të rendit, pra është një pushtetar dhe administrator i kohës. Detyra e lartë e administratorit që ushtronte në atë hapësirë e bënte të gëzojë respektin e të gjithëve. Është enigmatik, që thelbin e vetë ekzistencial, për faktin që kishte kohë që po i shtypte kokën dashurisë së ndaluar, madje edhe të pashprehur, që ushqente për Doruntinën, dashuri kjo që e detyron të dalë jashtë rregullave jetësore dhe ato të detyrës. Fakti që ai jep dorëheqje, nga detyra e tij, na bën të kuptojmë që ai ka shkelur aty ku nuk duhej, dhe për këtë veprim e kishte të qartë fare mirë që s’do gjente mirëkuptim dhe paqe, andaj pa e zgjatur largohet nga detyra dhe nga vendi për të mos u parë më.

Ndihmësi – është personazhi që na shfaqet si njeriu më besnik i kapiten Stresit, që përplotëson fytyrën e pushtetit të kohës. Edhe pse në disa raste me hetimet që bën për të kuptuar mënyrën se si erdhi Doruntina, kush e solli, a ka mundësi që Konstandini të ngrihet nga varri, vetëm për të mbajtur fjalën e dhënë, sikur luan rol kyç në zbulimin e enigmës mbi sjellësin e Doruntinës, në të vërtetë nuk luan asnjë rol, më tepër janë një situatë e sjelljes rreth vetes, në një qark të mbyllur, pa mundur të kuptojnë kahjet reale të lëvizjes së jetës në atë hapësirë.

Vajtojcat - përbënin grupin e grave naive, të cilat në këtë rast mbase ishin të vetmet që vërtet besuan në ringjalljen e Konstandinit. Vajtojcat, bartin një figurim të dyfishtë, nga njëra anë zërin kolektiv, të asaj gjëme që ka ndodhur, në anën tjetër, sjellin jehonën e korit të lashtësisë. Ata, në hapësirën e tekstit të kësaj proze, nuk luajtën ndonjë rol të rëndësishëm në ngjarje përveç që kryen në mënyrë profesionale vajtimet mbi Doruntinën dhe nënën e saj.